**VENDIM**
**Nr. 42, datë 6.6.2018**

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR ZOTËRIMIN NGA BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA TË 100 PËR QIND TË KAPITALIT AKSIONAR TË BANKËS NBG ALBANIA SHA**

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës "e", të nenit 43 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, të shkronjës "gj", të pikës 1, të nenit 24, si dhe të nenit 25, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, dhe të pikës 18, të shtojcës nr. 1, të rregullores "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare", miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010, të Këshillit Mbikëqyrës, të ndryshuar, dhe me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për zotërimin e 100 për qind të aksioneve me të drejtë vote të kapitalit aksionar të Bankës NBG Albania sh.a. nga Banka Amerikane e Investimeve sh.a.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
**Gent Sejko**